

Data 14.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje makine bot uji”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Automjete
34100000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 000 000 (Katër milion) lekë pa T.V.SH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gjirokaster** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo me te vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “b”, të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislativitetit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe nenin 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të**

vogel se 20% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit me shpenzimet e veta.

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës deklaron se malli i ofruar përmbush të gjitha specifikimet teknike të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ngarkojë në SPE foto të automjetit si dhe katalogun teknik të prodhimit të përkthyer dhe noterizuar të kësaj të fundit ku të jenë të evidentueshme secila prej specifikimeve të kerkuara nga ana e AK ose Leje e Qarkullimit.

2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë për garancinë e automjetit për një periudhë 6 muajore nga data e dorëzimit tek AK.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Automjet makinë bot uji për vaditje dhe larje rruge.

1. Të dhëna të përgjithshme të mjetit

- Viti i prodhimit: Jo më i vjetër se 2015 (përfshirë 2015)
- Fuqia e motorit: 220 – 300 kW
- Cilindrata: 4000 – 7500 cc
- Norma e emetimeve: Minimumi EURO 5

- Lloji i karburantit: Diesel
- Transmisioni: Manual
- Numri i akseve: 2
- Konfigurimi: 4x2
- Diferencial i bllokuar: Opsional

2. Parametrat e peshës

- Pesha totale e lejuar: 19.000 kg - 21,000 kg
- Pesha bosh: 6,800 kg-8,000 kg
- Ngarkesa e dobishme: 10,000 – 12,000 kg

3. Sistemi i cisternës

- Kapaciteti i cisternës: 9000 litra -11,000 litra
- Materiali: Çelik i trajtuar kundër korrozionit
- I pajisur me:
 - Motopompë për ngarkim dhe shkarkim
 - Sistem daljeje me rrjedhje të lirë për vaditje
 - Valvula sigurie dhe kontroll presioni

II. SPECIFIKAT TEKNIKE TË AGREGATIT

- Shina anësore alumini të fiksuara në trup
- Shllang zjarrfikëse universale
- Tub me fllanxhë Min Ø 80 mm, Min gjatësi 20 m
- Pajisje sprucimi uji me 3 sprucatorë të mëdhenj
- Dalje për vaditje me rënie të lirë
- 2 furça për pastrim sipërfaqesh:
 - Diametër minimal 40 cm
 - Diametër maksimal 60 cm
- Pajisje shkume portative me funksionim deri në Min 20 m distancë nga mjeti

Motopompa

- Motor me ftohje
- Fuqi: 30 – 50 kW
- Pompë centrifugale me presion të lartë
- Kapacitet: 20,000-23,000 litra/orë

4.Makina te kete pershkuare jo me shume se 150.000- 250.000 km origjinale.

5. Opsionet e makines :

- Kondicioner me funksional.

- Gomat te mos jene te konsumuara me shume se 20%

6.Sistemet baze te mjetit te jene funksionale dhe pa problem:

-sistemi I drejtimit

-sistem frenimi

- sistemi I trasmesionit kardanik.

-Sistemi pamore dhe zanor

- Automjeti duhet te jete i pajisur me dokumentacionin ligjor në momentin e dorzimit si me poshte:

1. Leje qarkullimi
2. Targe
3. Akte kolaudimi (te vlefshme te leshuara ne republiken e shqiperis)
4. Certificate pronesia ne emer te ofertuesit.
5. Siguracion

7.Automjeti do te merret ne dorzim nga investitori (Bashkia Gjirokaster) me komision te posacem.

8.Ne momentin e dorzimit te jene shlyer te gjitha detyrimet, taksa ,gjoba e detyrimet te tjera ligjore n.q.se ka.

9.Dorzimi i Automjetit do te kryhet nga kontraktuesi me shpenzimet e veta ne adresen e autoritetit kontraktor.

10.Te gjitha shpenzimet e mesiperme dp te perfshihen ne cemimin e ofertes.

11.Automjeti do te kete garanci difektesh per nje perjudhe 6 (gjashte) mujore nga dita e dorzimit tek investitori dhe shitesi do te pergjigjet per riparimin e difekteve jo me vone se tre dite nga data e njoftimit.

12.Difektet te cilat perfshin perjudha e garancise jane si me poshte:

- difekte motorike

- difekte te kutise se shpejtesise

- difekte te pompes se ujit

- difekte te paketave elektrike

- difekte te sistemit hidraulik

13.Percaktimi i shkakut te difektit do te kryhet nga nje ekspert i miratuar me pelqimin e paleve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSI E PROKURIMIT

Esmeralda Bezhani

Lorjana Shehu

Alfons Alikaj